

VENDIM
Nr.873, datë 22.12.2004

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR KRIJIMIN E
FORUMIT RAJONAL TË NISMËS SË MIGRIMIT, AZILIMIT DHE KTHIMIT TË
REFUGJATËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit për krijimin e forumit rajonal të nismës së migrimit, azilimit dhe kthimit të refugjatëve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**PROCESI I BASHKËPUNIMIT TË EUROPËS JUGLINDORE (SEECP)
MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
KRIJIMI I FORUMIT RAJONAL TË NISMËS SË MIGRIMIT, AZILIMIT DHE KTHIMIT
TË REFUGJATËVE**

Duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal në fushën e azilimit, migrimit, menaxhimit të kufijve, vizave, kthimit apo vendosjes së refugjatëve, si pjesë thelbësore e integritit evropian brenda procesit të SA, Axhendës së Selanikut dhe Paktit të Stabilitetit;

duke konfirmuar vendimin e marrë në takimin e parë qeveritar të forumit të MARRI-it, zhvilluar nën kujdesin e Presidencës së Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Malit të Zi në 5 prill 2004 në Herceg-Novî, duke qenë në të njëjtën linjë me mbështetjen e marrë nëpërmjet “Deklaratës së Sarajevës” në Samitin e Kryetarëve të Shteteve të SEECP në 21 prill;

për të formalizuar transferimin e MARRI-t në pronësi rajonale, nëpërmjet krijimit të forumit rajonal dhe ngritjes së qendrës së MARRI-t në rajon, përfaqësuesit e poshtëshënuar nga Republika e Shqipërisë, Republika e Kroacisë, Republika e Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës kanë arritur një mirëkuptim të përbashkët në kuadrin operativ dhe institucional për të menaxhuar forumin rajonal nëpërmjet:

1. Krijimit të Presidencës së forumit rajonal të MARR-it, bazuar në rotacionin vjetor ndërmjet vendeve të përfshira në procesin e Sap.

2. Delegimin e Presidencës për të marrë nismën, organizuar dhe drejtuar takime në nivel ministror dhe ekspertësh.

3. Vendosjen për krijimin e një sekretariati mbështetës/administrativ për forumin, qendrën rajonale të MARRI-it në Shkup, sipas termave të referencës sa më poshtë këtij memorandumi dhe mirëpresin ofertën e qeverisë mikpritëse për të siguruar lehtësirat, kostot operative dhe kuadrin institucional për qendrën.

4. Autorizimin e Presidencës për Republikën e Shqipërisë që të nënshkruajë me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen e mikpritjes dhe ngritjes së qendrës rajonale të MARRI-t në Shkup.

5. Emërimin e Sekretarit Ekzekutiv, sipas procedurave të rëna dakord, bashkëngjitur qendrës së MARRI-t, i cili do të shërbejë si kryetar për të asistuar Presidencën dhe për të koordinuar punën e forumit rajonal.

6. Mbajtjen e lidhjeve me institucionet bashkëpunuese europiane dhe transatlantike, si BE-në, NATO-n, OSBE-në dhe Paktin e Stabilitetit dhe të vazhdojë të kërkojë mbështetjen dhe këshillimin ndërkombëtar nëpërmjet takimeve të rregullta të organizuara me “Miq të forumit rajonal”.

7. Rënies dakord që qendra rajonale e MARRI-t të përbëhet nga një shumicë ekspertësh të propozuar nga vendet në rajon dhe të mbështetet nga ekspertët ndërkombëtarë sipas kërkesave.

8. Rënies dakord për të kontribuar në kërkesat për staf pranë qendrës rajonale, me të paktën një ekspert kombëtar për çdo shtet pjesëmarrës nëpërmjet sekondimit dhe personelit shtesë sipas kërkesave në konsultim me kryetarin e qendrës dhe Presidencën e forumit.

9. Mirëkuptimin që një pasqyrë e plotë e personelit përbërës, termave të referencës për secilin pozicion dhe buxheti vjetor, do të trajtohen nga Sekretariati i MARRI-it në bashkëpunim me Presidencën dhe të konsiderohet nga forumi rajonal.

10. Sigurimin e pagës bazë dhe shtesat, sigurimin shoqëror dhe siguracionet e ekspertëve kombëtarë nga vendet dërguese, me mirëkuptimin që kostot shtesë, si udhëtime, komunikimi dhe dietat të mbulohen nga buxheti i qendrës rajonale.

11. Rënies dakord për të siguruar pas vitit 2005, mundësitë për financimin e një pjese të caktuar të buxhetit e kontributit të Qeverisë së Maqedonisë, për të qeverisur lehtësirat në përputhje me nevojat e marra në konsideratë bashkërisht.

12. Vazhdimin si hap të parë për të mbështetur dhe lehtësuar zbatimin e iniciativave të mëposhtme të MARRI-it:

- Përfundimin dhe zbatimin e planeve kombëtare të veprimit në fushën e azilimit dhe migrimit;

- Seminare rreth planeve kombëtare të veprimit;

- Seminare me vendet e SAp dhe ato aderuese rreth shkëmbimit të informacionit dhe mësimave të nxjerra në fushën e uljes së migrimit të parregullt;

- Krijimin e një mekanizmi rajonal për të mbështetur negocimet me vendet e origjinës, ato transite dhe vendmbërritjeve, me qëllim uljen e migrimit të parregullt;

- “Aksesi për të drejtat dhe qytetarinë” — Iniciativë që synon nxitjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për problemet e refugjatëve dhe të të zhvendosurve, nëse ata zgjedhin të kthehen apo të vendosen diku tjetër; duke iu përkushtuar kështu procesit dhe sigurimin e një mbështetje të plotë në nivel kombëtar dhe rajonal për zbatimin e projektit, duke synuar arritjen e një aksesit pa rezerva dhe pa diskriminuar të drejtat themelore humane, ekonomike dhe sociale të të gjithë atyre qytetarëve të rajonit që mbajnë ende statusin e të zhvendosurit;

- Zhvillimin e një sistemi mbarërajonal të teknologjisë informative për menaxhimin e lëvizjeve të popullsisë për të gjitha llojet e aplikimeve në fushën e azilimit, migrimit, zhvendosjes dhe vizave, përmes projektit të MARRI-t të shkëmbimit të informacionit rajonal (RIE) duke pasur parasysh rëndësinë e zbatimit të legjislacionit përkatës për mbrojtjen e informacionit dhe konfidentalitetit;

- Realizimin dhe koordinimin e aktiviteteve me qëllim arritjen e lëvizjes së lirë të mallrave dhe kapitaleve nga njëra anë dhe lëvizjen e lirë të njerëzve nga ana tjetër, gjë e cila do të kërkojë një politikë të harmonizuar të vizave dhe masa të tjera në përputhje me rekomandimet e bëra në programet e veprimit të MARRI-t;

- Nxitjen dhe zhvillimin e aksesit në informacionin e cilësisë së lartë të vendeve të origjinës.

1. Duke pranuar që si pasojë e transferimit të përgjegjësi nga Pakti i Stabilitetit në pronësinë e rajonit përmes SEECp, forumi dhe qendra rajonale nuk janë pjesë e Paktit të Stabilitetit. Megjithatë forumi rajonal dhe qendra rajonale do të kenë një lidhje të veçantë me Paktin e Stabilitetit si “iniciativë e asociuar e Paktit të Stabilitetit” dhe si rrjedhojë do të ftohet të marrë pjesë në takimet e Tryezës Rajonale të Paktit të Stabilitetit. Në këto takime forumi rajonal dhe qendra rajonale do t’i raportojnë Paktit të Stabilitetit rreth aktiviteteve në zhvillim.

Nënshkruar në Tiranë, më datë 2 korrik 2004.

Republika e Shqipërisë
Bosnjë- Herzegovina
Republika e Kroacisë
Republika e Maqedonisë
Serbia dhe Mali i Zi

